VENDIM
Nr. 471, datë 26.6.2026

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 910, DATË 22.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK NDËRKOMBËTAR KFOR, KOSOVË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 910, datë 22.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak ndërkombëtar KFOR, Kosovë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, togfjalëshi "... 10 (dhjetë) ..." zëvendësohet me "... 12 (dymbëdhjetë) ...";

b) Në pikën 4, togfjalëshi "... çdo 6 (gjashtë) muaj ..." zëvendësohet me "... deri në 6 (gjashtë) muaj ...".

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, për vitin 2026.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu